

VENDIM
Nr.869, datë 19.12.2007

**PËR DHËNIE ASISTENCE EKONOMIKE TË MENJËHERSHME PERSONAVE,
QË PËRFITOJNË PENSION**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “ç” të nenit 66 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përfitojnë asistencë ekonomike të menjëhershme, në shumën 5 000 (pesë mijë) lekë:
 - a) personat, që marrin pension pleqërie, pension invaliditeti dhe pension familjar, sipas ligjeve nr.4171, datë 13.9.1966 “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”, dhe nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;
 - b) personat, që marrin pension, sipas ligjit nr.4976, datë 29.6.1972 “Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën Popullore të Shqipërisë” dhe sipas paragrafit të katërt të nenit 96 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;
 - c) veteranët e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, që trajtohen me shpërblim mujor, sipas ligjit nr.7874, datë 17.11.1994 “Për statusin e veteranit të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar”, personat, që marrin pension për merita të veçanta, sipas ligjit nr.4171, datë 13.9.1966 “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë” dhe personat, që marrin pension të posaçëm shtetëror, të cilët nuk përfitojnë pension pleqërie, invaliditeti apo familjar;
 - ç) personat, që marrin trajtim të veçantë financiar, sipas ligjit nr.8685, datë 22.6.2000 “Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në miniera, në nëntokë”, të ndryshuar, si dhe personat, që përfitojnë trajtim të veçantë financiar, sipas ligjit nr.9179, datë 29.1.2004 “Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake”, të ndryshuar.
 2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përlllogariten në shumën 2 711 970 000 (dy miliardë e shtatëqind e njëmbëdhjetë milionë e nëntëqind e shtatëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga Buxheti i Shtetit dhe të përdoren, përkatësisht:
 - a) 2 683 370 000 (dy miliardë e gjashtëqind e tetëdhjetë e tre milionë e treqind e shtatëdhjetë mijë) lekë, për asistencën e menjëhershme të pensionistëve;
 - b) 28 600 000 (njëzet e tetë milionë e gjashtëqind mijë) lekë, për mbulimin e komisioneve të shërbimit të pagesave dhe për shpenzimet administrative.
 3. Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, në buxhetin e miratuar për vitin 2007, në programin “Mbrojtja sociale”, t’i shtohet fondi 2 600 000 000 (dy miliardë e gjashtëqind milionë) lekë, ndërsa shuma 111 970 000 (njëqind e njëmbëdhjetë milionë e nëntëqind e shtatëdhjetë mijë) lekë të përballohet nga transferata e Buxhetit të Shtetit, për sigurimet shoqërore.
 4. Procedurat e pagesës së asistencës së menjëhershme për pensionistët të realizohen nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Posta Shqiptare sh.a.
 5. Ngarkohen Ministria e Financave, ministritë e linjës dhe të gjitha institucionet qendrore për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha